



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА E МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.12.2023, ka miratuar sa vijon,

## VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 12-5317/1 të datës 14.11.2023, e formuar sipas denoncimit të dorëzuar kundër u.d drejtor në -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent, ndërsa denoncimi të dorëzohet për veprim kompetent në Inspektorati Shtetëror Administrativ dhe për njohje me Qytetin e Shkupit.

Lënda me numër 12-5317/1 të datës 14.11.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 14.11.2023 është dorëzuar denoncim me pretendime kundër u.d drejtor në ----- dhe u formua lënda me numër 12-5317/1 të datës 14.11.2023.

parashtruesi thekson se duke vepruar u.d drejtori i ----- ka dy muaj pushim mjekësor me mendimin e komisionit të nivelit të dytë, por pushimin mjekësor nuk e dorëzon në institucion dhe nuk i zbritet paga. Në vijim thuhet se gjatë kohës që ishte në pushim mjekësor ka dhënë autorizim verbal për ndryshimin e personit të angazhuar me kontratën e autorit. Gjithashtu, kërkuesi paraqet konstatimet e tij se gjambat nga punonjësit kanë përfunduar në llogarinë e tij personale.

Pas shqyrtimit të pretendimeve nga denoncimi, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin konkret dhe raportin për veprim kompetent ta dorëzojë në Inspektoratin Shtetëror Administrativ dhe për njohje me Qytetin e Shkupit, pas së cilës vendosi, si në dispozitivin e këtij vendimi.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија  
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: [contact@dksk.org.mk](mailto:contact@dksk.org.mk)

тел/tel: +389 2 3248 930

<http://www.dksk.mk>

Përgatiti: B.K.SH  
Miratöi: S.P.D., anëtar i KSHPK-së

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР  
ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Nënkryetar,**

**Sofka Pejovska Dojçinovska**

